



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-041

Prishtinë, më 27 tetor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Müfera Şinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga KDI-ja: Shefki Kastrati,

Nga KDI-ja: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 19 dhe 20 tetor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 19 dhe 20 tetor 2015.

Ndërsa nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, pati vërejtje në transkriptin e mbledhjes së 20 tetorit 2015, në faqen 6, rreshti 2, ku ishte evidentuar gabimisht fjala “venerik”, ndërsa është dashur të jetë “venerim”. Transkripti është korrigjuar.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, e ngrehu shqetësimin lidhur me rrjedhën e seancave plenare, përkatësisht deputetët e grupeve parlamentare të opozitës po e bllokojnë punën e Kuvendit duke u barrikaduar para foltores së seancës dhe duke hedhur gaz lotsjellës.

Ai theksoi se këto veprime të opozitës për bllokimin e Kuvendit janë të papranueshme dhe po e rrezikojnë edhe shëndetin e deputetëve në sallë. Ai propozoi që Kryesia e Kuvendit të kërkojë nga organet përgjegjëse të sigurisë që t’i ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e duhura që të mos lejojnë askënd të fusë mjete në Kuvend për ta bllokuar punën e Kuvendit dhe për ta dëmtuar shëndetin e deputetëve.

Lidhur me shqetësimin që e ngrehu z. Adem Grabovci diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti; kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri; kryetari i Grupit Parlamentar të LS-së, Slavko Simiq dhe kryetarja e Grupit Parlamentar “6+”, Mufera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që t’i drejtohet me një shkresë Qeverisë së Kosovës, përkatësisht drejtuesve të organeve përgjegjëse për siguri që t’i ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për të siguruar kushte normale që Kuvendi t’i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësit e veta kushtuese dhe ligjore pa u penguar nga askush. Organet e sigurisë duhet ta njoftojnë Kuvendit deri të enjten, më 29 tetor 2015, për të garantuar siguri, në mënyrë që Kuvendi të vazhdojë me punë në kushte normale.

Gjithashtu, Kryesia e Kuvendit do të takohet edhe një herë të enjten, më 29 tetor 2015, për të shqyrtuar përgjigjen e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të drejtuesve të organeve përgjegjëse të sigurisë për masat dhe veprimet e tyre për të siguruar kushte normale për punën e Kuvendit.

* * *

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të pranishëm të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet të hënën, më 2 nëntor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentëshofer,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,*
12. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misionëve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës,*
13. *Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin 2014,*
14. *Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014,*
15. *Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014,*
16. *Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015,*
17. *Përzgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,*
18. *Propozim-vendimi për dhënien e pëlqimit për rinovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për rinovimin e sheshit “Adem Jashari”

Kërkesa e lartshënuar u radhit për shqyrtim në rend të ditës për seancën plenare.

2. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani prej 7-11 shtator 2015

Kryesia u njoftua nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani prej 7-11 shtator 2015.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale